



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the Secretary General

Nr. 92 /2026
Datë: 22 /07 /2026

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në nenin 4 (paragrafi 1) të Ligjit nr. 08/L-013 për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-290, në pajtim me nenin 3 (paragrafi 2) të Rregullores MD-nr. 03/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores MD-nr.07/2023 për procedurën e përcaktimit dhe verifikimit të reciprocitetit, kushtet, përmbajtjen dhe mënyrën e mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme nga të huajt në Kosovë, si dhe në përputhje me nenin 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës, bazuar në shkresën nr. [REDACTED] të datës 13 tetor 2023 të Ministrisë për Evropën dhe Punë të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, konfirmon se [REDACTED] shtetas i Republikës së Shqipërisë, mund të jetë titullar i të drejtave pronësore në Republikën e Kosovës në pajtim me kufizimet e të drejtave pronësore në pronën e paluajtshme për personin e huaj të përcaktuar në Ligjin nr. 08/L-013 për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës.
2. Kufizimet ligjore për fitimin e të drejtës pronësore në pronën e paluajtshme sipas legjislacionit përkatës të Republikës së Shqipërisë për shtetasit e Republikës së Kosovës, të cilat nuk i përcakton legjislacioni përkatës në Republikën e Kosovës, do të zbatohen edhe për shtetasin shqiptar nga pika 1 e këtij vendimi në Kosovë, në pajtim me parimin e reciprocitetit.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe vlen një (1) vit nga dita e plotfuqishmërisë së tij.

A r s y e t i m

[REDACTED] me nr. identifikues [REDACTED] ka parashtruar në Ministrinë e Drejtësisë kërkesën nr. 04-962 me datë 13.7.2026 për dhënien e pëlqimit për fitimin e të drejtave pronësore në Republikën e Kosovës.

Ministria e Drejtësisë e ka shqyrtuar kërkesën e [REDACTED] për përcaktimin e reciprocitetit për fitimin e të drejtës pronësore në Republikën e Kosovës dhe shkresat tjera të lëndës të

bashkëngjitura, në pajtim me nenin 4 (paragrafi 1) të Ligjit nr. 08/L-013 për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës, si dhe bazuar në nenin 3 (paragrafi 2) të Rregullores MD-nr. 03/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores MD-nr.07/2023 për procedurën e përcaktimit dhe verifikimit të reciprocitetit, kushtet, përmbajtjen dhe mënyrën e mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për fitimin e së drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme nga të huajt në Kosovë, ka marrë informacionet përkatëse për fitimin e të drejtave pronësore të shtetasve të huaj sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në shkresën [REDAKTUAR], të datës 13 tetor 2023 të Ministrisë për Evropën dhe Punë të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, në të cilën ndër të tjera potencohet se: *"Ligji nuk parashikon dispozita specifike/preferenciale për shtetasit nga Kosova. Të gjithë shtetasit e huaj mund të blejnë pasuri të paluajtshme në Shqipëri (përfshirë tokat bujqësore të cilat mund të merren në përdorim deri në 99 vjet), duke e regjistruar atë direkt në emrin e tyre individual ose në një strukturë, kompani apo partneritet", shtetasit e Republikës së Shqipërisë, mund të fitojnë të drejtën e pronësisë së paluajtshme në Republikën e Kosovës në pajtim me kufizimet e përcaktuara në Ligjin nr.08/L-013 për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës, i cili në nenin 5 (1) ndër të tjera përcakton: "Reciprociteti ekziston kur një shtetas i Republikës së Kosovës ose një person juridik me seli në Kosovë mund të fitojë të drejtën në pronë të paluajtshme në shtetin e shtetasit të huaj nën kushtet e njëjta nën të cilat shtetasit e huaj mund të fitojnë të drejtën në pronën e paluajtshme në Republikën e Kosovës".*

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ridvan Hoti

Sekretari Përgjithshëm



Vendimi u dërgohet:

- [REDAKTUAR]
- Kabinetit të Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Drejtësisë në detyrë;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.